

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7879  
E shtunë, 7 shtator 2024  
Çmimi 0.50

Përfundon peticioni me  
13 mijë nënshkrime,  
kërkohej ligj për parandalimin  
e vetëvrasjes | F. 7



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



## KDI-ja KËRKON NGA KUVENDI MË SHUMË ANGAZHIM NË LIGJVËNIE DHE MBIKËQYRJE TË QEVERISË | F. 4-5



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar raportin vlerësues për punën e Kuvendit të Kosovës gjatë sesionit pranveror janar-korrik 2024. Violeta Haxholli, menaxhere e

projektit, tha se Kuvendi gjatë këtij sesioni ka shënuar rënie në aktivitetin e tij, duke vënë theksin se për gjithsej 13 javë pune nuk janë organizuar fare seanca. KDI-ja kërkon nga Kuvendi t'i

shmangë mangësitë që kanë karakterizuar sesionin pranveror dhe sesionet e mëhershme, duke kërkuar më shumë angazhim në ligjvënien dhe mbikëqyrjen të qeverisë

DEBATI HARRIS  
- TRUMP NË  
NJË FAZË  
SHUMË TË  
RËNDËSISHME  
TË FUSHATËS  
PRESIDENCIALE | F. 3



SBASHK-u ME NISMË PËR MBLEDHJEN  
E NËNSHKRIMEVE, KËRKON NDRYSHIME  
TË SKEMËS PENSIONALE | F. 5



### OPINION

ÇFARË PO FSHIHET PRAPA  
"QETËSISË" NË VERI TË KOSOVËS | F. 7

Behxhet Sh. SHALA -  
BAJGORA



### AKTUALE



MALI I ZI NË RRUGË MË TË SHPEJTË  
TË ANËTARËSIMIT NË BE, SERBIA  
MBETET MBRAPA | F. 2

BE-ja NUK JEP HOLLËSI RRETH  
TËRHEQJES SË LETRËS SË  
BËRNABIQIT | F. 5

LANSOHET PROJEKTI "MBROJTJA  
E TË DREJTËS PËR TË QENË  
VETVETJA" QË SYNON BARAZI  
PËR TË GJITHË | F. 3

### EKONOMI



AS 350 EURO NUK I PËRMBUSHIN  
NEVOJAT BAZË PËR DISA QYTETARË | F. 8

### SPORT



SHOIPËRIA PËSON HUMBJE NGA  
GJEORGJIA NË 'AIR ALBANIA' | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Mali i Zi në rrugë më të shpejtë të anëtarësimit në BE, Serbia mbetet mbrapa

**PODGORICË, 10 SHTATOR** - Mali i Zi dhe Serbia vazhdojnë të konsiderohen vende udhëheqëse në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian por, në rrethanat ekzistuese, vetëm Mali i Zi mund të shpresojë për anëtarësim të plotë deri në fund të kësaj dekade.

Ky vend ka marrë Raport pozitiv të Vlerësimit të Standardeve nga BE-ja, ndërsa Serbia vazhdon të mos u bashkohet sanksioneve të bllokut kundër Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Nga perspektiva e Brukselit, kjo bën që Mali i Zi të shihet si anëtar i parë i ardhshëm i BE-së.

Mali i Zi i ka hapur negociatat për anëtarësim në qershor të vitit 2012, ndërsa Serbia në janar të vitit 2014.

Fazat ku këto dy vende janë tani në procesin e anëtarësimit janë thelbësisht të ndryshme.

Deri më tani Serbia ka hapur 22 nga gjithsej 35 kapituj të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Nga ata 22, ajo i ka mbyllur përkohësisht 2.

Negociatat në mes të Beogradit dhe Brukselit janë praktikisht të ngrira tash e tre vjet për shkak të mosvendosjes së sanksioneve kundër Rusisë.

Mali i Zi, në anën tjetër, i ka hapur të gjithë kapitujt e negociatave dhe ka mbyllur përkohësisht 3. Pas disa vitesh stagnim, ky vend i ka rinisur negociatat në qershor të këtij viti dhe tani po punon drejt mbylljes së tyre.

Serbia dhe Mali i Zi jozyrtarisht janë trajtuar në grup, përkatësisht si dy vendet më të avancuara në procesin e negociatave të anëtarësimit.

Me narrativën e Brukselit, ato janë quajtur "lidere" në procesin e anëtarësimit.

Por, pasi Mali i Zi ka rinisur

procesin e negociatave në qershor, ndërsa Serbia nuk tregon shenja se do të vendosë sanksione kundër Rusisë dhe në këtë mënyrë t'i "shkrijë" negociatat, e ashtuquajtura "ndarje" mes tyre ndodh natyrshëm. Dhe, aktualisht, ka vetëm një lider drejt anëtarësimit në BE dhe ai është Mali i Zi.

Jana Juzova nga Instituti për Politika Evropiane - EUROPEUM thotë se Serbia ka ende një rrugë të gjatë përpara për të treguar se përpiqet realisht të bëjë reforma demokratike. "Për shkak të rrugës që po kalon Serbia në aspektin e performancës demokratike dhe marrëdhënive me Rusinë, mendoj se aktualisht nuk ka asnjë argument për 'bashkimin' e Malit të Zi dhe Serbisë", thotë Juzova. "Nëse elita qeverisëse më prodemokratike dhe më properëndimore do të shfaqeshin në Serbi dhe vendi do ta përshpejtonte ritmin e reformave, atëherë situata do të mund të ndryshonte dhe ndoshta do t'i kishim përsëri dy lidere", shton ajo. Në "garën" e kandidatëve për integrimin evropian, Serbia, sipas saj, është shndërruar në një "fëmijë problematik" në Ballkanin Perëndimor.

## Mali i Zi në BE më 2028, një opion i mundshëm dhe optimist

Ekspertët e Komisionit Evropian nuk e përjashtojnë mundësinë që Mali i Zi, me vullnet politik, t'i mbyllë të gjithë kapitujt e negociatave gjatë dy viteve të ardhshëm për t'i hapur rrugë anëtarësimit të plotë në BE deri në fund të kësaj dekade.

Në Drejtorinë e Zgjerimit të Komisionit Evropian tashmë



ekziston një plan i përgatitur kalendarik, sipas të cilit, Mali i Zi do të mund ta përmbyllte të gjithë procesin e negociatave për anëtarësim deri në vitin 2026. Sipas këtij plani, Mali i Zi mund t'i mbyllë katër kapitujt të negociatave këtë vit, gjashtë kapitujt janë planifikuar të mbyllën gjatë vitit 2025 dhe të gjithë kapitujt e mbetur gjatë vitit 2026. "Koha e parashikuar për mbylljen e përkohshme të kapitujve pasqyron vlerësimin e Komisionit Evropian për kompleksitetin e arritjes së asaj faze. Afatet reale do të varen nga rezultatet e ofruara nga Mali i Zi dhe pikëpamjet e shteteve anëtare dhe mund të ndryshojnë nga tre deri në gjashtë muaj, me përjashtim të atyre kapitujve që janë planifikuar të mbyllën në fund të vitit 2026, që është afati politik për mbylljen e negociatave", thuhet në dokumentin e Komisionit Evropian që ka parë "Radio Evropa e Lirë". Sipas këtij plani dhe në

rrethanat më ideale, Mali i Zi mund të bëhet anëtar i BE-së në vitin 2028.

Periodha hipotetike ndërmjet viteve 2026 dhe 2028 - pra ndërmjet përfundimit të negociatave dhe anëtarësimit të plotë - është e nevojshme, në mënyrë që të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian - 27 prej tyre - ta ratifikojnë marrëveshjen e anëtarësimit në parlamentet e tyre kombëtare. "Mali i Zi i ka shanset më të mira nëse e ruan vulltin e sapopërfutur dhe tregon rezultate bindëse në zbatimin e shtetit të drejtës dhe të reformave demokratike", thotë Juzova.

Gert Jan Kopman, drejtor i përgjithshëm në Drejtorinë për Fqinjësi dhe Negociata të Zgjerimit, beson se anëtarësimi i Malit të Zi në BE deri në vitin 2028 është "real", nëse Podgorica zyrtare angazhohet seriozisht. "Për sa i përket motivimit për vetë vendin, [caktimi i vitit 2028 si afat për anëtarësim] është shumë i

dobishëm. Është një gjë transformuese sepse çdo javë do të mbahen mbledhje të kabinetit, ku do të shqyrtohet progresi", tha Kopman në një panel në Bruksel kushtuar zgjerimit.

Në reagimet zyrtare, zyrtarët e Komisionit Evropian janë më të kujdesshëm kur bëhet fjalë për datat.

Në një deklaratë me shkrim për Radion Evropa e Lirë, shërbimi për shtyp i Komisionit Evropian tha se presidentja e këtij institucioni, Ursula von der Leyen, tashmë ka konfirmuar se zgjerimi do të jetë prioritet në mandatin e saj të ardhshëm dhe se Komisioni është duke punuar për ta përshpejtuar punën dhe për ta përshpejtuar integrimin gradual të Ballkanit Perëndimor. "Nuk ka afate të paracaktuara. Është e qartë se anëtarësimi mbetet një proces i bazuar në merita, plotësisht i varur nga progresi objektiv i secilit partner", thuhet në deklaratën e Komisionit Evropian.

## Gjermania ashpëron kontrollet kufitare

**BERLIN, 10 SHTATOR** - Gjermania më 9 shtator forcoi kontrollet kufitare për ta luftuar migrimin ilegal, pas disa sulmeve të dyshuara të kryera nga islamistët që nxitën zemërimin e publikut dhe rritën presionin ndaj qeverisë.

Kontrollet e përkohshme do të aplikohen në kufijtë tokësorë të Gjermanisë me nëntë fqinjët e saj të Bashkimit Evropian, tha ministrja e Brendshme gjermane. Këto kontrolle synojnë ta luftojnë migrimin dhe "ta mbrojnë shtetin kundër rreziqeve akute që paraqet terrorizmi islamist dhe krimet serioze", tha ministrja e Brendshme, Nancy Faeser, në një konferencë për medie.

Qeveria e kancelarit gjerman Olaf



Scholz është përballur me presion në rritje për ta frenuar migrimin ilegal dhe për ta luftuar ekstremizmin pas disa sulmeve të dyshuara islamiste.

Muajin e kaluar tre persona u

vrانë gjatë një sulmi me thikë në Solingen, dhe i dyshuari i sulmit, një sirian, edhe pse ishte urdhëruar që të largohej nga vendi, kishte shmangur forcat e sigurisë.

Përgjegjësinë për sulmin e mori grupi ekstremist Shteti Islamik. Gjermania veçse kishte aplikuar kontrolle të përkohshme përgjatë kufirit të saj me Austrinë, kontrolle që janë në fuqi që nga viti 2015 për ta luftuar fluksin e migrantëve.

Vitin e kaluar Berlini, po ashtu, vendosi kontrolle të përkohshme kufitare në kufijtë e tij me Poloninë, Republikën Çeke dhe Zvicrën, në mes të shqetësimeve se fluksi i migrantëve mund të rritet.

Tani Gjermania ka vendosur që të aplikojë kontrolle kufitare edhe në kufijtë e saj tokësorë me Francën, Luksemburgun, Belgjikën, Holandën dhe

Danimarkën, tha qeveria. Ky njoftim vjen teksa Berlini është zotuar se do t'i rrisë përpjekjet që t'i dëbojë azilkërkuesit që janë të dënuar për krime të ndryshme. Muajin e kaluar Gjermania për herë të parë ktheu 28 afganë qëkur talebanët morën pushtetin në Afganistan më 2021.

Qeveria po bën "gjithçka që t'o mbrojnë më mirë njerëzit dhe shtetin tonë", tha Faeser të hënën, duke shtuar se do t'i kthejë mbrapsht edhe migrantët në kufi. Sipas saj, qëkur autoritetet rivendosën kontrollet kufitare në kufirin lindor gjerman tetorin e vitit të kaluar, afër 30 000 personave u është ndaluar hyrja në Gjermani.

# KDI-ja kërkon nga Kuvendi më shumë angazhim në ligjvënien dhe mbikëqyrje të qeverisë



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar raportin vlerësues për punën e Kuvendit të Kosovës gjatë sesionit pranveror janar-korrik 2024. Violeta Haxholli, menaxhere e projektit, tha se Kuvendi gjatë këtij sesioni ka shënuar rënie në aktivitetin e tij, duke vënë theksin se për gjithsej 13 javë pune nuk janë organizuar fare seanca. KDI-ja kërkon nga Kuvendi t'i shmangë mangësitë që kanë karakterizuar sesionin pranveror dhe sesionet e mëhershme, duke kërkuar më shumë angazhim në ligjvënien dhe mbikëqyrje të qeverisë

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të martën konferencë për medie në të cilën ka shpalosur raportin vlerësues për punën e Kuvendit të Kosovës gjatë sesionit pranveror janar-korrik 2024.

Violeta Haxholli, menaxhere e projektit, tha se Kuvendi gjatë këtij sesioni ka shënuar një rënie në aktivitetin e tij, duke vënë theksin se për gjithsej 13 javë pune nuk janë organizuar fare seanca. Nga janari deri në fund të muajit korrik, Kuvendi zhvilloi 29 seanca, 10 prej të cilave ishin seanca plenare, kurse për shkak të mungesës së kuorumit kishte 7 vazhdime të këtyre seancave.

Ndërsa janë mbajtur edhe 6 seanca të jashtëzakonshme dhe 6 seanca solemne.

Përkundër rekomandimeve të vazhdueshme të KDI-së për planifikim më të mirë dhe racional të punës, rendi i ditës për të gjitha seancat e rregullta ishte i stërngarkuar dhe nuk arriti të trajtohet asnjëherë në tërësi. Si rezultat, pikat e rendit të ditës kanë vazhduar të barten nga seanca në seancë. Shkak kryesor për mosrealizim të rendit të ditës mbetet mungesa e kuorumit të nevojshëm. Vetëm në këtë sesion deputetët munguan 525 herë, apo mesatarisht për çdo seancë munguan 24,3 % e deputetëve. Haxholli shtoi se përgjatë sesionit janë miratuar gjithsej 36 projektligje, numër ky më i ulët sesa në sesionin e njëjtë të vitit të

kaluar, kur ishin miratuar 44 projektligje. Shprehur në përqindje, agenda e Kuvendit është përbushur 28 %. Nga 36 projektligje të miratuara, vetëm 3 projektligje janë pjesë e agjendës legislative të ekzekutivit të vitit 2024, që do të thotë se më pak se 1 % e agjendës legislative 2024 të qeverisë është miratuar gjatë këtij sesioni. Të tjerat projektligje që u miratuan ishin ato që për vite kishin mbetur në procedurë.

Miratimi i projektligjeve është përcjellë me një dinamikë jouniforme dhe të pabalancuar. Për shembull, në 3 muajt e parë të sesionit pranveror janë miratuar vetëm 2 projektligje, kurse 3 muajt pasues 34 të tjerë. Në anën tjetër, 44 projektligje ende mbesin në procedurë, ndër to 22 projektligje nga agenda e qeverisë e vitit 2024. Ndonëse kishte më pak raste të përdorimit të gjuhës joparlamentare në seanca, situata ishte ndryshe në mbledhjet e komisioneve, veçanërisht në mbledhjet e komisioneve hetimore. Në mjaft raste deputetët iu drejtuan njëri-tjetrit me shprehje ofenduese.

Sa i përket mbikëqyrjes parlamentare, Haxholli shtoi se gjatë këtij sesioni nuk u ftua asnjëherë në raportim kryeministri dhe nuk u organizuan interpelanca. Megjithatë, deputetët parashtruan 110 pyetje për qeverinë, ndonëse numri i

pyetjeve krahasuar me sesionin pranveror të vitit të kaluar ishte më i ulët. Pyetjet u përsëritën disa herë për shkak të mungesës së përgjigjeve nga ana e ministrave, duke çuar në rritje të numrit të pyetjeve të parashtruara. Qeveria në përgjithësi ofroi vetëm 33 përgjigje, ndërsa përgjigje nuk kanë ofruar kryeministri Kurti të cilit i janë parashtruar pyetje 36 herë dhe disa nga ministrat e kabinetit si, ministri Xhelal Sveçla, ministria Arbërie Nagavci e ministria Rozeta Hajdari. Ministri Hekuran Murati ka ofruar vetëm dy përgjigje, ndonëse i janë parashtruar pyetje 28 herë.

Haxholli foli edhe për temat kryesore gjatë këtij sesioni, ndërsa prej tyre u veçuan diskutimet rreth Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve, Projektligji i ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe përfundimi i draftimit të Kodit të Sjelljes nga Komisioni për Legjislacionin, i cili ende pret miratimin përfundimtar në seancë.

Puna e 14 komisioneve parlamentare gjatë sesionit pranveror u kornizua në gjithsej 193 mbledhje në të cilat janë përfshirë edhe dëgjimet publike dhe dëgjimet mbikëqyrëse. Ndërsa komisionet hetimore mbajtën 36 mbledhje. Komisionet ftuan në raportim 15 herë përfaqësuesit e ekzekutivit,

mesatarisht një raportim për komision.

Gjatë sesionit kanë vazhduar punimet për rikthimin e sistemit të votimit elektronik pas plot tri viteve qëkur ai ishte jashtë funksionit. Kjo ka bërë që edhe në këtë sesion të votohet "me dorë", gjë që në disa raste ka vënë në dyshim numërimin e saktë të votave. Në anën tjetër, disa nga komisionet vazhduan të mos publikojnë procesverbalet dhe transkriptimet nga mbledhjet e komisioneve, siç e parashihet Rregullorja e Kuvendit. Ndërsa Kuvendi vazhdoi të mos publikojë asnjë informacion lidhur me mbledhjet e komisioneve ad-hoc dhe hetimore.

Në javën e fillimit të sesionit vjeshtor, KDI kërkon nga Kuvendi t'i shmangë mangësitë që kanë karakterizuar sesionin pranveror dhe sesionet e mëhershme, me planifikim të mirëfilltë të seancave dhe organizim të seancave çdo javë, pjesëmarrje të rregullt të deputetëve në punimet e Kuvendit, rritje të mbikëqyrjes ndaj ekzekutivit, rol më aktiv të kryetarit të Kuvendit në zbatimin e Rregullores dhe garantim të transparencës së Kuvendit ndaj publikut.

Po ashtu, Kuvendi duhet ta miratojë gjatë sesionit vjeshtor edhe Kodin e Sjelljes së Deputetëve, i cili për disa muaj pret miratimin përfundimtar.

## Lansohet projekti "Mbrotja e të drejtës për të qenë vetvetja" që synon barazi për të gjithë

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Ish-presidentja Atifete Jahjaga, bashkë me ambasadorin e Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ishin pjesë e ceremonisë së lansimit të

projektit "Mbrotja e të drejtës për të qenë vetvetja". "Nëpërmjet këtij projekti do të përpiqemi t'i eliminojmë sfidat që cenojnë vlera të tilla. Ky projekt do të

implementohet nga Fondacionit 'Jahjaga', CEL dhe CSGD", është shprehur Jahjaga. Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot,

ngriti shqetësimet për lëvizjet anti-gjinore dhe anti-LGBT+, për çka theksoi se shteti francez është i përkushtuar për të qëndruar kundër këtyre lëvizjeve.





## Debati Harris - Trump në një fazë shumë të rëndësishme të fushatës presidenciale

WASHINGTON, 10 SHTATOR - Debati mes nënpresidentës demokrate Kamala Harris dhe ish-presidentit republikan Donald Trump, që do të mbahet të martën, mund të jetë një nga momentet kritike të fushatës për zgjedhjet presidenciale të 5 nëntorit në Shtetet e Bashkuara.

Dy kandidatët nuk janë takuar asnjëherë me njëri-tjetrin dhe nuk kanë zhvilluar asnjë bisedë në telefon, por të martën ata do të qëndrojnë në një distancë të afërt nga njëri-tjetri në Qendrën Kombëtare të Kushtetutës në qytetin e Filadelfias. Ata pritet të shkëmbejnë kritika me njëri-tjetrin për 90 minuta, ndërsa u përgjigjen pyetjeve të parashtruara nga dy gazetarë të kanalit ABC, David Muir dhe Lindsey Davis.

Dhjetëra miliona amerikanë pritet ta ndjekin debatin mes dy kandidatëve presidencialë. Ky mund të jetë debati i vetëm mes tyre në fushatën për zgjedhjet presidenciale të 5 nëntorit.

Debati mbahet tetë javë përpara ditës zyrtare të zgjedhjeve, por vetëm disa ditë përpara fillimit të votimit të hershëm në disa nga 50 shtetet e vendit.

Anketat tregojnë se gara është e ngushtë, duke e bërë edhe më të rëndësishëm paraqitjen e mirë për dy kandidatët në debatin, në të cilin ata do të do të përpiqen ta tërheqin mbështetjen e një numri të vogël votuesish.

Amerikanët këtë vit do të zgjedhin mes kthimit të ish-presidentit

Trump në Shtëpinë e Bardhë dhe daljes së nënpresidentës Harris si kandidate demokrate për postin e presidentes.

Pasi Bideni u tërhoq nga gara për president në korrik për shkak të paraqitjes së dobët në debatin e parë me Trumpin në fund të qershorit, ai mbështeti Harrisin si kandidate për presidente. Demokratët u bashkuan shpejt dhe në Kuvendin Kombëtar të partisë së tyre emëruan zyrtarisht Harrisin kandidate për presidente. Ndërsa presidenti Biden ishte mbrapa Trumpit në anketa kur ai u tërhoq nga gara, nënpresidentja Harris ka një epërsi prej dy ose tre pikësh ndaj Trumpit në anketat në shkallë vendi.

Rezultatet e një ankete të gazetës "New York Times" dhe Kolegjit Siena, të publikuar të dielën, e nxjerrin Trumpin në epërsi 48 me 47% në shkallë vendi. Megjithatë, gazeta "New York Times" tha gjithashtu se bazuar në rezultatet e shumë anketave të fundit, Harris ka një epërsi ndaj Trumpit në tri shtete vendimtare: Viskonsin, Miçigan dhe Pensilvani dhe ka mbështetje të barabartë me Trumpin në katër shtete të tjera të rëndësishme: Arizona, Xhorxhia, Nevada dhe Karolinën e Veriut.

Këto shtatë shtetet pritet të luajnë një rol të madh në përcaktimin e rezultatit të zgjedhjeve. Në Shtetet e Bashkuara një kandidat bëhet president duke siguruar votat elektorale dhe jo duke fituar shumicën e votave popullore në

shkallë vendi.

Anketa e re e gazetës "New York Times" dhe Kolegjit Siena tregon se debati është më i rëndësishëm për demokraten Kamala Harris, sepse 28% të të anketuarve thanë se duhet të dinë më shumë për të, ndërsa vetëm 9% thanë të njëjtën gjë për Trumpin. Pra, Harris ka nevojë të bëjë një prezantim para publikut amerikan në debatin e së martës më shumë sesa ish-presidenti Trump.

Eksperti i debateve në Universitetin e Miçiganit, Aaron Kall, i tha "Zërit të Amerikës" se "Debati i së martës është një nga debatet me pritshmërinë dhe rëndësinë më të madhe të të gjitha kohëve. Zoti Trump ka më shumë përvojë me debatet presidenciale, por ai ka një histori të bërjes së komenteve të debatueshme për rivalët në skenë, të cilat mund ta largojnë vëmendjen nga diskutimi i çështjeve të rëndësishme mbi politikën". "Harris sapo hyri në garë në korrik dhe ende po gjykohej nga votuesit dhe ekipi fushatës së Trumpit. Ajo duhet të dëshmojë se mund t'i kritikojë politikën e ndjekura nga Trumpi kur ai ishte president dhe veprimet e tij të fundit", tha ai. "Trumpi është shumë efektiv me kundërgoditjet dhe mund të përdorë një strategji debati shkatërruese nëse mendon se po trajtohet padrejtësisht në skenë". Eksperti i debateve Kall shtoi: "Të dy kandidatët duhet t'i theksojnë biografite të tyre tërheqëse dhe aftësitë unike që i bëjnë ata të

kualifikuar për ta udhëhequr vendin gjatë katër viteve të ardhshme". Ai tha se të dy kandidatët "duhet t'i bëjnë këta votues të ndihen mirë me mundësinë që ata të jenë presidentët për katër vitet e ardhshme dhe figura të rregullta në ekranet e tyre televizive dhe në dhomat e tyre të ditës".

Harris po përgatitet për debatin në një hotel në Pitsburg të Pensilvanisë, një shtet i rëndësishëm për zgjedhjet. Ajo ka zhvilluar disa prova me një person që luan rolin e rivalit të saj Donald Trump, në një skenë që u ngjan atyre të përdorura nga kanalet televizive dhe me moderatorë që bëjnë pyetje të vështira.

Ish-presidenti Trump është angazhuar në seanca informimi mbi politikën me këshilltarët e tij, por pa bërë prova me një figurë të ngjashme me Harrisin.

Aborti, emigracioni në kufirin ShBA - Meksikë, shkalla e krimit në Shtetet e Bashkuara dhe karakteri personal janë ndër çështjet që gazetarët e kanalit ABC ka të ngjarë të përfshijnë në listën e pyetjeve për kandidatët.

Ndërkohë, Trumpi dhe Harris tashmë kanë shkëmbyer kritika në distancë.

Trumpi i tha gazetarit të kanalit Fox News Sean Hannity javën e kaluar se ai e la Bidenin të fliste në debatin e tyre në qershor, duke shtuar: "Unë do ta lë atë të flasë. Ka nga ata që thonë se Bideni është më i zgjuar se ajo. Nëse është kështu, ne kemi një

problem".

Trumpi ka fyer shpesh intelektin e Harrisit, duke thënë se ajo "nuk e ka idenë se çfarë po bën". "Shiko, kjo është një grua që është e rrezikshme", tha ai. "Nuk mund të rrezikoni. Nuk keni zgjidhje. Ju duhet të votoni për mua, edhe nëse nuk më pëlqeni".

Nënpresidentja Harris e ka tallur ish-presidentin Trump.

Në Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokrate muajin e kaluar, ndërsa ajo zyrtarisht pranoi emërimin si kandidate për presidente, zonja Harris tha: "Në shumë mënyra, Donald Trump është një njeri joserioz". Harris shtoi: "Por pasojat e rikthimit të Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë janë jashtëzakonisht serioze".

Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara vendosi së fundmi që zoti Trump dhe të gjithë presidentët e ardhshëm të Shteteve të Bashkuara kanë imunitet nga ndjekja penale për veprime të lidhura me detyrat e tyre zyrtare, për të cilat zonja Harris tha se do të jenë problematike nëse zoti Trump kthehet në Shtëpinë e Bardhë. "Vetëm imagjinoni Donald Trumpin pa kufizime dhe se si ai do ta përdorte pushtetin e pakufizuar të presidencës së Shteteve të Bashkuara. Jo për ta përmirësuar jetën tuaj, jo për ta forcuar sigurinë tonë kombëtare, por për t'i shërbyer të vetmit klient që ka pasur ndonjëherë, vetes së tij".

## BE-ja nuk jep hollësi rreth tërheqjes së letrës së Bërnabiqit

**PRISHTINË, 10 SHKURT** - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Peter Stano, nuk ka dashur të ofrojë më shumë hollësi për tërheqjen e letrës së ish-kryeministres së Serbisë, Ana Bërnabiq, lidhur me hezitimin e Serbisë për zbatim të Marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve me Kosovën.

Stano ka thënë se nuk ka çfarë të shtojë më shumë sesa deklaratat e të dërguarit të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Mirosllav Lajçak.

Vetë Lajçaku ka thënë ditë më parë në Kosovë vetëm se "letra është tërhequr".

Megjithatë, pak dihet se si është tërhequr letra, kur ka ndodhur kjo.

Serbia, në anën tjetër, nuk e ka konfirmuar këtë veprim. "Në emër të BE-së nuk kam çfarë t'i shtoj asaj që tha i dërguari i posaçëm, Mirosllav Lajçak, në takimet në Prishtinë, javën e shkuar, dhe nuk ka nevojë të përsëritet. Pse, kur dhe si ndodhi kjo, nuk është diçka që na takon neve, por u takon autoriteteve të Serbisë t'i adresojnë këto pyetje.

Mund ta përsëris qëndrimin e BE-së që është i vazhdueshëm që nga dita e parë e Marrëveshjes së Ohrit, e ajo është se të dyja palët kanë obligim ta zbatojnë Marrëveshjen, e cila është ligjërish obliguese. Të dyja palët duhet të punojnë pa vonesa në zbatimin e saj", ka thënë Stano. Sipas tij, asnjëra palë nuk do të mund të bëjë hapa përpara drejt integriteteve evropiane nëse nuk e zbaton këtë Marrëveshje.

Kosova dhe Serbia kanë arritur pajtueshmëri për normalizim marrëdhëniesh në shkurt të vitit të kaluar, ndërsa në mars të atij viti për një aneks zbatimi.

Ndonëse palët nuk i kanë nënshkruar ato marrëveshje, BE-ja insiston që ato janë ligjërish obliguese.

Marrëveshja prej 11 nenesh, ndër të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi që t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Lajçaku ka thënë gjatë vizitës në



Kosovë se është arritur pajtueshmëri për një raund të ri të dialogut mes dy vendeve, në nivel kryenegociatorësh, por pa përmendur datën.

Më 10 shtator ai është takuar në Beograd edhe me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Lajçaku nuk është deklaruar për

mediet, ndërsa Vuçiqi ka paralajmëruar se do t'i paraqesë kërkesat që ka Serbia për shkak të atyre që i ka konsideruar "sulme substanciale dhe brutale ndaj popullsisë serbe në veri të Kosovës".

Ai ka thënë së fundmi në një intervistë për Radion Evropa e

Lirë, se konsideron që shoqëritë në Kosovë dhe Serbi nuk janë gati për normalizim.

Kosova dhe Serbia dialogojnë në Bruksel me ndërmjetësimin e BE-së që prej vitit 2011. Palët kanë arritur disa marrëveshje, por deri tash vetëm disa janë zbatuar.

## Joseph: Serbët janë afër heqjes dorë nga jeta në Kosovë, kjo i konvenon Serbisë dhe Ruisë për ta minuar rendin perëndimor



**PRISHTINË, 10 SHTATOR** - Edward Joseph, ligjërues në Shkollën për Studime të Avancuara në "Johns Hopkins" në Uashington, ka thënë se serbët e Kosovës janë "afër heqjes dorë nga jeta në Kosovë" pas "fiaskos" në Banjskë, një rezultat që, sipas tij, do t'u shkonte përshtati vetëm planeve serbe dhe ruse për ta minuar rendin perëndimor e multietnik në rajonin e trazuar të Ballkanit

Perëndimor.

Në një artikull autorial të botuar në revistën amerikane "Foreign Policy" të martën, ai ka kritikuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për shkak të "lëvizjeve provokuese" në veri të territorit të Kosovës të banuar me shumicë serbe, duke thënë se "veprimet e njëanshme" të Kurtit rrezikojnë ta "zhbëjnë" Kushtetutën e Kosovës e cila garanton një vend të sigurt për

pakicën serbe. "Kurti, pavarësisht prej sanksioneve të ShBA-së dhe BE-së, ka vazhduar 'instrumentalizimin' e Policisë së Kosovës në veri pas vendimit katastrofik të besnikëve të Serbisë për t'i larguar serbët nga forca policore dhe institucionet e tjera në nëntor 2022", ka theksuar Joseph, ndërsa ka shkruar rreth nevojës për ridefinimin e politikës së jashtme amerikane në

administratën e re. "Kurti vazhdon populizmin e papërgjegjshëm për një arsye kundërintuitive: Qytetarët e Kosovës, dhe shumë në Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, e shohin Kurtin figurën e vetme që i kundërvihet Serbisë, ndaj së cilës nuk ka pasur asnjë pasojë për veprimet apo mosveprimet që çuan në konfrontim të dhunshëm me paqeruajtësit e NATO-s", ka shtuar Joseph.

Ditët e fundit kanë qarkulluar "informacione" se Serbia është duke planifikuar zhvendosjen e serbëve të Kosovës, posaçërisht atyre që përbëjnë shumicën në veri të vendit, në rajonin e Sanxhakut. Agon Maliqi, analist i politikës ballkanike e aktivist i shoqërisë civile, ka argumentuar së fundi se Qeveria e Kosovës rrezikon të bjerë në "grackën" e Serbisë dhe Ruisë.

## Abdixhiku pret në takim shefin e ri të BE-së, diskutojnë për zhvillimet e fundit në vend

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pritur në takim shefin e ri të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav. Gjatë këtij takimi kryetari Abdixhiku i uroi ambasadorit Orav suksese në detyrën e tij të re dhe

shprehu besimin se bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe BE-së do të vazhdojë në frymën e vlerave dhe parimeve të përbashkëta. Abdixhiku e njoftoi ambasadorin Orav lidhur me qëndrimet e LDK-së rreth zhvillimeve të fundit politike në vend si dhe

përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme të 9 shkurtit, ndërsa i prezantoi dhe programin politik "Rruga e Re". Abdixhiku falënderoi shefin e ri të Zyrës së BE-së në Kosovë Aivo Orav për bashkëpunimin e vazhdueshëm në mes të BE-së dhe Kosovës.



## Përfundon peticioni me 13 mijë nënshkrime, kërkohet ligj për parandalimin e vetëvrasjes

**EPOKA E RE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Mbi 13 mijë qytetarë e kanë nënshkruar peticionin i cili kërkon nga deputetët e Kuvendit të Kosovës ta miratojnë Projektligjin për parandalimin e vetëvrasjes. Me këtë rast, peticioni me nënshkrime të qytetarëve është dërguar në Kuvend, teksa u hodhën kritika në drejtim të kryetarit të Kuvendit, Glauk Konjufca, për "qasje jo serioze". Drejtori i "Linjës së Jetës", Bind Skeja, tha se me rastin e ditës ndërkombëtare të parandalimit të vetëvrasjes kanë përfunduar me sukses këtë peticion. Andaj, kërkoi nga ligjvënësit ta përpilojnë projektligjin për parandalimin e vetëvrasjes. "Sot



për ditën botërore të parandalimit të vetëvrasjes, ne kemi përfunduar peticionin për projektligjin për parandalim të

vetëvrasjes me mbi 13 361 nënshkrime nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Kjo shënon një arritje të

jashtëzakonshme në trajtimin e vetëvrasjes në Kosovë, duke filluar për herë të parë procesin e hartimit të politikave të cilat

preokupimin kryesor e kanë reduktimin e vetëvrasjeve nëpërmjet trajtimit të dinjitetshëm të bashkëqytetarëve tanë. Ju rikujtoj se nëpërmjet këtij peticioni ne kërkojmë një ligj që rregullon, shërbimet klinike për parandalim të vetëvrasjes. Integrimin e parandalimit të vetëvrasjes në objektiva institucionale. Mekanizma për ngritje të profesionalizmit dhe kujdesit të medie ndaj rasteve të raportimit të vetëvrasjes. Shërbime dhe mbështetje sociale joklinike", ka thënë Skeja, duke shtuar se peticionin e kanë dorëzuar në Kuvendin e Kosovës, por nuk janë pritur nga Konjufca qysh parashihet me ligj. "Kjo për neve e tregon një qasje joserioze", u shpreh Skeja.

## SBASHK-u me nismë për mbledhjen e nënshkrimeve, kërkon ndryshime të skemës pensionale

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se kanë iniciuar një nismë për mbledhjen e nënshkrimeve për ndryshimin e skemës pensionale në vend. Sipas tij, kjo nismë ka për qëllim që punëtorëve të arsimit të viteve '90 t'u llogariten si vite kontributdhënëse, ndërsa është i bindur në mbledhjen e mbi 10 mijë nënshkrimeve. "Duke respektuar qëndrimet e përfaqësuesve të SBASHK-ut që nga çerdhet e deri në universitet, kemi ardhur në një përfundim të fillojmë një nismë me mbledhjen e nënshkrimeve nga anëtarësia jonë, por edhe nga qytetarët t'i drejtohem Kuvendit të Kosovës që ta ndërrojë pjesën e ligjit për



skemën pensionale. Kohën e fundit me ndryshimin e bërë janë mohuar të drejtat e punëtorëve të arsimit", ka thënë Jasharaj, teksa shpreh bindjen se ligjvënësve do t'u dërgohen më shumë se 10 mijë nënshkrime. "Kjo nismë ka për qëllim që t'i kthehet e drejta që u ka bërë vetë parlamenti punëtorëve të arsimit të viteve '90 që këto vite të jenë vite kontributdhënëse që ta marrin pensionin e plotë. Kjo do të ndihmonte jo vetëm punëtorët e arsimit po të gjithë sektorët publikë, që ta arrijnë kriterin për 15 vjet. Jam i sigurt se jo vetëm 10 mijë po shumë më shume nënshkrime do të mblihdhen për një afat shumë të shkurtër, e pastaj do t'ua dërgojmë organeve përgjegjëse", ka thënë Jasharaj.

## Osmani ftohet në samitin global "Vital Voices Summit" në Poloni

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Poloni për të marrë pjesë në Samitin global "Vital Voices Summit". Në këtë samit, presidentja Osmani do të jetë folëse kryesore në një bashkëbisedim me temën për "Gratë për të drejta dhe

demokraci", në moderimin e ambasadores Melanne Vermeer, drejtoreshë ekzekutive e Institutit Georgetown për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, njëherësh Ambasadorja e parë e ShBA-së për Çështjet Globale të Grave dhe Bashkëthemeluese e Vital Voices.

"Vital Voices", që nga themelimi i saj në 1997, ka mbështetur drejtpërdrejt më shumë se 20 000 gra prijëse të ndryshimeve në 185 vende të botës dhe ka ndërtuar rrjetin më të fuqishëm global të grave lidere që angazhohen për një botë më të barabartë për të gjithë.





# As 350 euro nuk i përmbushin nevojat bazë për disa qytetarë



**PRISHTINË, 10 SHTATOR** - "Vështirë për Zotin, por duhet t'ia dalim"... Kështu nis rrëfimin Sejdi Salihu, i cili, si punonjës teknik në një shkollë fillore të Prishtinës, thotë se paguhet 274 euro në muaj. Prej tyre, mbi 100 euro i duhen për shpenzimet komunale të familjes së tij katëranëtarëshe. "Jemi mësuar të heqim, gjithmonë... Po shpresojmë të bëhet më mirë", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Në fund të gushtit Qeveria e Kosovës mori vendim që paga minimale në vend të jetë 350 euro, nisur nga 1 tetori i këtij viti. E pandryshuar nga viti 2011, vlera e saj aktualisht është 130-170 euro.

Sipas udhëheqësve qeveritarë, vendimi i ri do t'i prekë rreth 150 000 punonjës, të cilët punojnë me paga më të ulëta se 350 euro, kryesisht në sektorin privat. Por, as kjo shumë, sipas ekspertëve të ekonomisë, "nuk e mbush shportën e produkteve për një familje me tre apo katër anëtarë". Kritika kanë edhe sindikalistët e sektorit privat, të cilët thonë se qeveria nuk është konsultuar me ta për vlerën e pagës minimale dhe vendimin për të e konsiderojnë si "fushatë zgjedhore" përpara zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit.

Salihu thotë se nuk pret që kjo rritje e pagës minimale ta rrisë

edhe mirëqenien e familjes së tij. Bashkëshortja e tij bën punë të ngjashme si ai, por në një shkollë tjetër, dhe merr, po ashtu, rreth 270 euro në muaj. "[Rritja e pagës minimale] ndoshta ndikon pak, por shumë pak ose fare. Shpenzimet janë shumë të mëdha. Fëmijët po kërkojnë... jeta vazhdimisht kërkon të holla", thotë 53-vjeçari.

Ai tregon se për shërbimet komunale, përfshirë energjinë elektrike dhe komunikimet, familjes së tij i duhen më shumë se 100 euro në muaj, ndërsa për ushqime më shumë se 300. "Nëse blen miellin, sheqerin, kripën, vajin, groshën, patatat, makaronat, vezët, ndonjëherë mish apo suxhuk, pra, më rrallë - sërish pa i shpenzuar deri në 10 euro në cikërrima të tjera, është e pamundur... Kur vjen vjeshta, po duhen drurët, turshitë...", thotë Salihu. "Po të mos ishte ndihma e mërgatës, mbetesh pykë", shton ai, duke treguar se vëllai që jeton në Perëndim, e ndihmon muaj për muaj.

"Radio Evropa e Lirë" ka raportuar më herët se vendimi për pagën minimale ka ngritur disa dilema ligjore, pasi Qeveria e Kosovës, siç është thënë, nuk është konsultuar me përfaqësuesit e punëtorëve dhe të punëdhënësve për vlerën e saj, ashtu siç e kërkon ligji.

Jusuf Azemi, kryetar i Sindikatës së Pavarur të Sektorit Privat, përsërit se paga minimale është caktuar nga qeveria, pa u konsultuar dhe pa i njoftuar sindikalistët. Sipas tij, bazuar në koston e jetesës në Kosovë paga minimale do të duhej të ishte rreth 700 euro, porse sindikalistët kanë sugjeruar që ajo të jetë së paku 500 euro.

Ai thotë se shuma prej 350 eurosh nënkupton që një familje katëranëtarëshe të shpenzojë më pak se 12 euro në ditë. "Kjo i bie që për çdo kokë të familjes të ketë 2.70 ose 2.80 euro", thotë Azemi - shumë kjo që, sipas tij, nuk krijon as bazë minimale sociale për njerëzit.

Azemi thotë se sindikatat kanë kërkuar rritjen e pagës minimale që nga fillimi i mandatit të qeverisë aktuale, në vitin 2021, por thekson se ky hap është ndërmarrë gati në fund të mandatit, përkatësisht pas ardhshme. "Unë nuk e kam quajtur pagë minimale, por pagë parazgjedhore, sepse kjo është një pagë përmes së cilës [Qeveria] dëshiron të marrë vota. Përndryshe, gjendjen sociale të punëtorëve, nuk e ndryshon", thotë Azemi.

Lulzim Rafuna, kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës, e cila përfaqëson bizneset private, thotë se shumica e bizneseve e

tejkalojnë nivelin e pagës minimale, të caktuar së fundmi nga qeveria.

Në atë minimale, sipas tij, janë vetëm pagat që japin bizneset private që ndërlihen me sektorin publik, ku ofrojnë shërbime teknike dhe paguhen nga institucionet publike. "Po të na jepej mundësia, ne, si sektor privat, mbase brenda mundësive që i kemi, do të propozonim një nivel tjetër më të madh të pagës. Por, ka qenë tërësisht mungesë e konsultimit dhe informimit të sektorit privat", thotë Rafuna për "Radion Evropa e Lirë".

Ai shton se zotimi i qeverisë, se paga minimale prej 350 eurosh do të lirohet nga tatimi për të ardhurat personale, kërkon ndryshime ligjore, të cilat është sfidë të arrihen deri më 1 tetor.

## Paga minimale varësisht inflacionit

Në anën tjetër, profesori i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Mejdi Bektashi, thotë se paga minimale duhet të lëvizë varësisht inflacionit. Që nga shpërthimi i luftës gjithëpërfshirëse në Ukrainë, në vitin 2022, inflacioni gjetiu në botë ka shënuar rritje.

Ndonëse gjatë vitit të fundit ka qenë më stabil, të dhënat e Agjencisë së Statistikave të

Kosovës tregojnë se në korrik të këtij viti çmimet e konsumit kanë shënuar rritje për 2.2 për qind, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Mendoj se paga minimale, për të siguruar një jetesë të dinjitetshme, duhet të jetë së paku 450 euro dhe në vitet e ardhshme të bëhet indeksimi i saj me rritjen e inflacionit", thotë Bektashi. Sipas tij, me 350 euro "nuk mbushet shporta e produkteve për një familje me tre apo katër anëtarë".

Ai nuk pret që kjo vlerë e pagës minimale të ndikojë në ngritjen e çmimeve në treg. "Unë nuk besoj se kjo ngritje ose vlera që do të paguhet për rritjen e pagës minimale, do të ndikojë në sasinë e eurove në qarkullim. Fundja, inflacioni te ne nuk buron nga prodhimi vendor, por është inflacioni i importuar", thotë Bektashi për "Radion Evropa e Lirë".

Në Kosovë, Agjencia e Statistikave nuk ka të dhëna se sa kushton shporta e konsumatorit. Por, çmimet e produkteve bazë, gjatë dy vjetëve të fundit, janë rritur vazhdimisht. "Radio Evropa e Lirë" ka sjellë disa herë rrëfime të qytetarëve, që mezi ia dalin t'i përmbushin nevojat mujore. Paga mesatare në Kosovë është rreth 520 euro, ndërsa shkalla e papunësisë sillet në rreth 10 për qind.

## Bulliqi takon përfaqësuesit e bizneseve lokale

**PODUJEVË, 10 SHTATOR** - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka zhvilluar takim me

bizneset lokale për t'i falënderuar ato për ndihmën dhe kontributin e ofruar për organizimin dhe zhvillimin e

Manifestimit "Ditët e Diasporës". Në shenjë respekti dhe falënderimi përfaqësuesve të bizneseve u

janë dhënë mirënjohje në emër të kryetarit të komunës dhe është organizuar një koktej rasti.





# Ekonomia e Europës përpara një krize "ekzistenciale"

A do të jenë sipërmarrjet në Europë në varësi prej konkurrencës nga Amerika e Veriut dhe Azia? Ish-shefi i Bankës Qendrore Europiane (BQE) Mario Draghi në analizën e tij nxjerr një konkluzion të qartë.

"Europa e ka humbur revolucionin digjital të shkaktuar nga interneti si dhe fitimet në produktivitet që lidhen me të", konstaton në raportin e tij ish-kreu i BQE-së, Mario Draghi. Presidentja e Komisionit të BE-së Ursula von der Leyen e pati autorizuar 77 vjeçarin Draghi që të bëjë një analizë të aftësisë konkurruese të BE-së. Në të Draghi tërheq vëmendjen, se Bashkimi Europian është i dobët në teknologjitë e reja, që do të nxisin rritjen e ardhshme ekonomike. Vetëm katër nga 50 sipërmarrjet e mëdha të teknologjisë janë firma europiane. Në sfondin e konkurrencës nga SHBA dhe Kina ish-kryeministri i Italisë, Draghi vëren, se europianët ndodhen përpara një "sfide ekzistenciale". Pa produktivitet më të lartë Europa nuk mund "të jetë lider në fushën e teknologjive të reja, as një fanar në përgjegjësinë për klimën dhe një aktore e pavarur në skenën botërore".

Edhe modeli social europian nuk mund të financohet më. Shkruan italiani në analizën e tij strategjike.

## "Investimet masive detyrimisht të nevojshme"

Draghi i bën thirrje BE-së për investime masive në ekonomi, mbrojtje dhe mbrojtjen e klimës. Të nevojshme janë edhe "investime minimale vjetore shtesë në vlerën 750 deri në 800 miliardë euro", këshillon ai. Për t'ia arritur këtij qëllimi ish-shefi i BQE-së rekomandon marrjen e borxheve të reja në bashkësi ashtu sikurse u veprua së fundi në rastin e pandemisë së koronavirusit. Edhe presidentja e Komisionit të BE-së, Ursula von der Leyen i konsideron instrumentat për financimin e bashkësisë si të rëndësishme. Por është i mundur edhe përdorimi i mjeteve financiare të vendeit përkatës, ku bëjnë pjesë doganat e importeve dhe kuotizacioni në BE për plastikën, tha von der Leyen e pyetur lidhur me rezistencën e qeverisë gjermane kundër borxheve të reja në bashkësi. Lidhur me këtë duhet të vendosin



vendet anëtare të BE-së.

Gjatë kohës së pandemisë BE organizoi një paktë ndihme të financuar me kredi në vlerën e 750 miliardë eurove. Vendet si Italia dhe Franca qysh atëherë kërkojnë një paketë të re duke iu referuar rritjes së shpenzimeve për mbrojtjen dhe mbrojtjen e klimës. Por Gjermania dhe Holanda borxhet e reja në bashkësi i konsiderojnë si vijë të kuqe.

"Politika për klimën duhet të koordinohet më mirë"

Duke iu referuar sektorëve me emisione gazrash të dëmshme për klimën si në industrinë e rëndë dhe transport, Draghi rekomandon për BE-në, që ta rregullojë më mirë politikën për klimën. Nëse të gjitha masat politike harmonizohen me objektivat për klimën, është "shumë e mundshme, që pakësimi i emisioneve të dioksidit të karbonit, dekarbonizimi në atmosferë, të jetë një shans për rritjen ekonomike", tha ai në një konferencë shtypi.

Von der Leyen dëshiron që ta bëjë BE-në me programin Green Deal deri në vitin 2050 neutrale ndaj klimës, kjo do të thotë, që Europa të mos emetojë më shumë gazra të efektit serë nga sa mund të kursejë. Përpara zgjedhjeve për Parlamentin e BE-së politikania kristiandemokrate gjermane, von der Leyen, në qershor e ndodhur nën presionin e konservatorëve dhe liberalëve, deklaroi se do të bëjë disa lëshime lidhur me kushtet e vendosura për mjedisin.

# SHBA: Dërgesa e raketave balistike iraniane në Rusi do të ishte 'përshkallëzim dramatik'

Furnizimi nga Irani me raketa balistike për Rusinë do paraqiste një "përshkallëzim dramatik" të përkrahjes së Teheranit për Moskën dhe Shtetet e Bashkuara janë gati të reagojnë me "pasoja dramatike", tha të hënën Departamenti amerikan i Shtetit.

"Çdo transferim i raketave balistike iraniane në Rusi do të përfaqësonte një përshkallëzim dramatik në mbështetjen e Iranit për agresionin e Rusisë kundër Ukrainës", u tha gazetarëve zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Vedant Patel.

Ministria e Jashtme e Ukrainës tha të hënën (9 shtator) se ka thirrur për një takim urgjent një diplomat të lartë iranian dhe për t'ia tërhequr vërejtjen mbi "pasojat katastrofike e të pariparueshme" në marrëdhëniet dypalëshe, nëse vërtetohen njoftimet se Teherani ka furnizuar me raketa balistike Rusinë.

Zyrtari i lartë iranian Shahriar Amouzegar, i hodhi poshtë njoftimet e së hënën në mëngjes, duke i cilësuar ato si "luftë psikologjike". Por një zëdhënësi i Bashkimit Evropian tha se informacionet ishin "të besueshme".

Rrjeti televiziv CNN dhe gazeta 'Wall Street Journal' njoftuan javën e kaluar, duke cituar burime të paidentifikuara, se Irani kishte dërguar raketa balistike me treze të shkurtër veprimi në Rusi, ndërkohë që Moskë vazhdon luftën ndaj Ukrainës, të cilën e filloi në vitin 2022. Ministria e Jashtme ukrainase

njoftoi në platformën 'Telegram' se i kishte tërhequr vërejtje të ngarkuarit me punë të Iranit, Shahriar Amouzegar dhe se e paralajmëroi atë në "mënyrë të ashpër" për pasojat në marrëdhëniet e tyre nëse konfirmohet dërgimi i raketave.

Më herët, agjencia iraniane e lajmeve citoi komandantin e lartë të Gardës Revolucionare të Iranit, Fazlollah Nozari, duke thënë: "Asnjë rakete nuk është dërguar në Rusi dhe ky pretendim është një lloj lufte psikologjike."

"Irani nuk përkrah asnjërin nga palët në konfliktin ndërmjet Ukrainës dhe Rusisë", deklaroi zoti Nozari.

Në të kaluarën, zyrtarët perëndimorë dhe ukrainas kanë hedhur poshtë përgënjeshtimet e tilla, duke thënë se ka prova të mjaftueshme që Irani ka furnizuar Rusinë me pajisje, siç janë dronët 'Shahed'.

Përmes një përgjigje me shkrim, zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano tha: "Jemi në dijeni të informacionit të besueshëm që na është dhënë nga aleatët për dërgesën e raketave balistike iraniane në Rusi".

Ai tha se nëse ky informacion konfirmohet, "dërgesa do të përbënte një përshkallëzim të rëndësishëm në aspektin material sa i përket përkrahjes së Iranit për luftën e jashtëligjshme të Rusisë kundër Ukrainës".

Udhëheqësit e BE-së e kanë bërë të qartë në të kaluarën se do "të



përgjigjen shpejt dhe në bashkërendim me partnerët ndërkombëtarë ndaj Iranit, përfshirë me masa të reja dhe kufizuese ndaj tij" për një hap të tillë, shtoi zëdhënësi Stano. Një zyrtar tjetër evropian, që foli me kusht që të mos identifikohet, tha se Shtetet e Bashkuara ndanë informacionin mbi këtë dërgesë me aleatët dhe se ka gjasë që do ta bëjnë së shpejti publik këtë informacion.

## "Përshkallëzim i rëndësishëm"

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov tha se ka parë raportet mbi

këtë zhvillim, po shtoi se jo të gjitha raportet e tilla janë të sakta.

"Irani është partner i rëndësishëm i yni, po zhvillojmë marrëdhëniet tona tregtare dhe ekonomike, po zhvillojmë bashkëpunimin dhe dialogun në të gjitha fushat e mundshme, përfshirë ato më të ndjeshmet", zëdhënësi Peskov u tha gazetarëve.


Javën e kaluar Ukraina tha se thellimi i bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Teheranit dhe Moskës paraqet kërcënim për Ukrainën, Evropën dhe Lindjen e Mesme dhe i bëri thirrje bashkësisë ndërkombëtare që të shtojë tryshinë ndaj Iranit dhe Rusisë.

Shtetet e Bashkuara thanë të premten se çfarëdo dërgese e raketave balistike iraniane Rusisë do të shënonte një përshkallëzim të thellë të luftës në Ukrainë.

Kësaj gjuhe i bëri jehonë të hënën një zëdhënësi i NATO-s, i cili tha se aleanca perëndimore ushtarake është në dijeni të njoftimeve të mediave, por se nuk mund të komentojë vërtetësinë e tyre.

"Siç kanë thënë aleatët në të kaluarën, çfarëdo dërgese e raketave ballistike dhe teknologjisë së ngjashme nga Irani për në Rusi do të përbënte një përshkallëzim të rëndësishëm", deklaroi zëdhënësi i NATO-s. /VOA

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Sonte finalja e Superkupës Prishtina - Trepça

Prishtinë, 10 shtator - Sonte (e mërkurë) zhvillohet finalja e Superkupës në mes të Sigal Prishtinës dhe Trepçës. "Bardhekaltrit" në gjysmëfinale kanë shënuar fitore ndaj Pejës me rezultat 91:80 (25:30, 22:16, 19:21, 25:13). Ndeshja, në fakt, ishte e baraspeshuar për 30 minuta, por në çerekun e fundit dhe vendimtar, bardhekaltrit ishin më të mirë për të

triumfuar 91:80, MVP i ndeshjes ishte Damire Burns i Sigal Prishtinës me 15 pikë, dhjetë kërcime e pesë asistime. Në anën tjetër Mitrovicasit kanë mundur Golden Eagle Yllin me rezultat të thellë 83:61 (27:16, 20:14, 19:10, 17:21). "Xehetarët" e nisën ndeshjen më mirë dhe nga fillimi e deri në fund ishin në epërsi. Fituesit aktualë të Superkupës e fituan çerekun e

parë 27:16, derisa me lojë të mirë vazhduan edhe në periudhën e dytë, 20:14, për të shkuar në pushim me shifrat 47:30. Në pjesën e dytë vetëm sa e ngritën epërsinë për të triumfuar 83:61. Mikaile Tmusiq ishte MVP i ndeshjes me 16 pikë, shtatë kërcime e shtatë asistime. Finalja Sigal Prishtina - Trepça zhvillohet të mërkurë nga ora 20:00.



## Shqipëria pëson humbje nga Gjeorgjia në 'Air Albania'

TIRANË, 10 SHTATOR - Shqipëria pësoi disfatë 0-1 ndaj Gjeorgjisë në "Air Albania", në ndeshjen e vlefshme për Ligën e Kombeve. Ndeshja nisi me një ritëm jo shumë të lartë, me ekipet që u treguan të kujdesshme. Arbër Hoxha lëshoi sinjale të qarta në minutën e 12-të, me një goditje nga distanca. Në të 25-tën, mysafirët u shfaqën të rrezikshëm, por Kvara nuk devijoi dot një top të ardhur nga krahët. Të besuarit e Sagnol shtuan presionin në fundin e fraksionit, duke vendosur në vështirësi prapavijën kuqezi. Në të 55-tën, Kitiashvili "flirtoi" me golin, me fat Shqipëria. Të besuarit e Sylvinhos iu afruan golit në minutën e 60-të, gjatë zhvillimit të një goditje këndi, një gjuajtje e Bajramit mund të ishte një asistim për Kumbullën,



që gjithsesi nuk shtyu topin në rrjetë. Gjeorgjia zhbllkoi ndeshjen në minutën e 71-të, me anë të Giorgi Kochorashvili. Pavarësisht rasteve, nuk pati asnjë ndryshim rezultati deri në

fund. "Ndeshje e vështirë, donim të sulmonim, por ata u mbrojtën me 5 e pastaj edhe me 3 mesfushor. Na vuri në vështirësi. Gjeorgjia është shumë e fortë, por edhe ne. Sot

nuk ishte dita jonë, por jemi në nivel të njëjtë. Ata e përgatitën ndeshjen mirë me kundërsulme, Bënë gol dhe ishte shumë e vështirë t'i çanim mbrapa. Kur dilnim në sulm duhet të isha afër Kvaras, ai bëri diferencën me ne që i shkonim pas dhe të tjerët shfrytëzuan mundësinë", ka thënë Ylber Ramadani. Shqipëria renditet në vendin e dytë në League B, pas dy ndeshjes ka grumbulluar 3 pikë. Gjeorgjia kryeson grupin, me 6 pikë. Pas fitores 3-2 ndaj Ukrainës, Çekia e dyta me 3 pikë.

Holanda e Gjermania u përplasën edhe njëherë me njëra-tjetrën, këtë herë në fazën e grupeve, të Ligës së Kombeve, në Ligën A, me sfidën e "Johan Crujff Arena", që u mbyll në barazimin spektakolar, 2-2. Për "Tulipanët" e Ronald Koeman gjetën rrugën e rrjetës Reijnders e Dumfries, ndërsa "Pancerat" e Nagelsmann u kundërpërgjigjën me golat e Deniz Undav e Joshua Kimmich, duke regjistruar kështu barazimin spektakolar, në arenën holandeze. Ndërkaq, në barazim ka përfunduar edhe sfida tjetër e mbrëmjes, në Ligën A, me Hungarinë, që ishte e pafat përballë Bosnje Hercegovinës, duke e mbyllur 90 minutëshin e lojës, me rezultatin 0-0.

### Holanda e Gjermania ndahen baras

Mund të quhet me plot gojë "klasikja" e futbollit evropian.

## FFK-ja reagon pas dhunës në ndeshjen Deçani - Prizreni: Dhuna është e patolerueshme



### "Epoka e re"

PRISHTINË, 10 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës ka reaguar ashpër dhe e ka dënuar fuqishëm incidentin e ndodhur gjatë ndeshjes së javës së dytë në Ligën e Dytë ndërmjet KF Deçani dhe KF Prizreni. "Sjelljet jospportive që

fillimisht u shfaqën në këtë takim nga disa lojtarë të KF Deçani, më pas edhe nga një lojtar i klubit prizrenas (të cilët kryen veprime që bien ndesh me frymën e sportit), janë të papranueshme dhe në kundërshtim të plotë me vlerat e futbollit. Edhe më shqetësues ishte përshkallëzimi i situatës që pasoi, ku përleshja mes futbollistëve në

fushë u përkeqësua me përfshirjen e personave civilë, të cilët sulmuan futbollistët e klubit prizrenas", thuhet në reagimin e FFK-së. Federata e Futbollit e Kosovës zotohet se nuk do ta tolerojë dhunën në futboll në asnjë formë dhe kërkon që të gjithë personat e përfshirë në këtë incident të japin përgjegjësi. Njëkohësisht, FFK-ja

kërkon nga komisionet përkatëse që të ndërmarrin masa rigorozë ndaj të gjithë atyre që kanë shkelur rregullat e lojës dhe etikën sportive, konform rregulloreve në fuqi. FFK-ja është e përkushtuar për të promovuar një ambient të sigurt dhe të drejtë në futbollin e Kosovës, ku respektohen parimet e "fair-play"-t dhe respekti mes klubeve.

## Bora paralajmëron se do të jetë skuadër e fortë në Superligë

Prishtinë, 10 shtator - Bora është skuadra më e re që është inkuadruar në Superligën e Kosovës në basketboll. Skuadra kryeqytetase kishte paraqitje të jashtëzakonshme në Ligën e Parë dhe në Superligë nuk janë futur si skuadrat e tjera që ka ndodhur vitet e fundit, duke u larguar pa lënë gjurmë. Se e kanë marrë seriozisht inkuadrimit në Superligë tregojnë edhe transferimet që kanë kryer drejtuesit e kësaj

skuadre. Të udhëhequr nga një emër i madh i basketbollit si Arben Krasniqi, Bora prezantoi ardhjen e parë basketbollistin Rezart Memed. Menjëherë pas tij Borës iu bashkua edhe Jetmir Zeqiri, Ardit Pepaj e të huajt si Jr Clay, Sha'Markus Kennedy, Isiah Mosley e Jalen Graham. Qysh në ndeshjen e parë zyrtare Bora tregoi se ka potencial të madh, ku në Superkupën e Kosovës në basketboll u përball me kampionin në fuqi Trepçën.

Bora tregoi lojë të fortë dhe vetëm në fund të ndeshjes u mposht nga Trepça. Kryeqytetasit janë një nga skuadrat më të organizuara në vend, derisa pritet të jenë arrë e fortë për secilën skuadër në Superligë. Ndeshjen e parë në kampionat Bora do ta zhvillojë të dielën ndaj Yllit, derisa pastaj luajnë me Sigal Prishtinën, Pejën, Bashkimin, Vëllaznimin, Proton Cable Prizrenin dhe në xhiron e shtatë me Trepçën.



## O'Neal: Basketbollisti më i keq i të gjitha kohëve është Gobert

**NJU-JORK, 10 SHTATOR** - Ish-basketbollisti Shaquille O'Neal ka qenë i ftuar në një program televiziv, ku ka bërë një deklaratë të bujshme. Ai e ka cilësuar basketbollistin Rudy Gobert si lojtarin më të

keq të të gjitha kohëve. I pyetur se cili ka qenë lojtari më i keq, ai i është përgjigjur prerazi: "Nëse firmos një kontratë prej 250 milionë dollarësh duhet të më tregosh se je një lojtar që e meriton

ato shumë", ka thënë O'Neal. "Ka njerëz si ai, Gobert, që përpiqen të përfitojnë nga sistemi, duke përfituar gjithë ato para dhe nuk dinë të luajnë. Ndaj këto tipa nuk i respektoj", ka deklaruar

O'Neal. Më tej, gjigandi amerikan shtoi: "Sa herë që bëj këto komente njerëzit mendojnë se unë e urrej atë, por janë thjesht faktet ato që më detyrojnë të bëj këto deklarata".



## KH Kastrioti po bëhet gati për Evropë, pret përkrahjen e shikuesve

**FERIZAJ, 10 SHTATOR** - Pas paraqitjes së dinjitetshme në ndeshjen për Superkupë, Kastrioti i Ferizajt u është kthyer përgatitjeve për sfidat ndërkombëtare.

Të shtunën prej orës 19:00 në palestrën "Bill Clinton" në Ferizaj, Kastrioti takohet me skuadrën e njohur nga Bosnjë-Hercegovina, Sloboda Tuzla. Është kjo ndeshja e parë e raundit të parë të Kupës Evropiane (EHF European Cup). Ndeshja e kthimit zhvillohet në Tuzla, më 22 shtator. Kastrioti synon suksesin në EHF European Cup dhe ndeshja e parë është shumë e rëndësishme. Ferizajasit janë të përkushtuar që të japin më të mirën për të arritur rezultat të favorshëm para ndeshjes së kthimit.

Për këtë Kastriotit i duhet edhe përkrahja e shikuesve. Prandaj të



shtunën mbrëma vendi i të gjithë adhuresve të hendbollit të Kosovës është në palestrën "Bill Clinton", në qytetin me traditë të pasur të hendbollit. Kastrioti është fitues në fuqi i Kupës së Kosovës,

ndërsa tani e ka edhe përvojën ndërkombëtare. Përballë ka kundërshtar të nivelit serioz, por ferizajasit shpresojnë shumë që me angazhimin e të gjithëve do të jenë të suksesshëm.

## DuBoef: Peshat e rënda nuk kanë kuptim pa duelin mes tyre, në një moment ata do të përballen në ring

**LONDËR, 10 SHTATOR** - Tyson Fury dhe Anthony Joshua kanë rrethuar njëri-tjetrin gjatë pjesës më të madhe të karrierës së tyre profesionale. Secili prej tyre ka fituar disa kampionate botërore, tituj të cilët të dy i kanë humbur tani dhe do të luftojnë për t'i rifituar. Por, përfundimisht rrugët e Furyt dhe Joshuas, dy britanikë dhe rivalë të mëdhenj të peshave të rënda, mund të kryqëzohen, edhe nëse nuk do të fitojnë domosdoshmërisht luftimet e tyre të ardhshme. "Gjithmonë kam ndier se AJ dhe Tyson do të luftojnë në një moment. Fiton, humb ose çfarëdo tjetër të ndodhë në ring", ka thënë Todd DuBoef, presidenti i Top Rank, kompania që promovon Tyson Fury në ShBA. "Ata janë si Batman dhe Robin. Ata shkojnë së bashku. Thjesht ndihem sikur në një moment ata do të luftojnë pavarësisht nga puna e tyre, pavarësisht se si dalin nga zënkat", ka shtuar DuBoef. "Mendoj se të dy kanë fansa të mëdhenj, të dy vijnë nga një vend i mrekullueshëm me histori. Ne kemi pasur këtë rilindje të mrekullueshme të peshave të



rënda, Britania e Madhe është epiqendra e saj, kështu që gjithmonë kam ndier se ata do të luftojnë në një moment", ka deklaruar promotori. Fury dhe Joshua janë të fokusuar në sfidat e tyre të menjëhershme, respektivisht ndaj Usykt dhe Dubois. "Unë mendoj se ka shumë të drejta mburrje dhe ata kanë pasur një rivalitet për 15 vjet ose çfarëdo qoftë ai dhe nuk mendoj se

do të zhduket ndonjëherë", ka deklaruar DuBoef. "Mayweather-Pacquiao ndodhi pas 10 viteve rivalitet, ndaj mendoj se kjo ka kuptim edhe për Furyt dhe Joshuan. Ju shikoni historinë. Në një moment mendoj se ata e mbyllin atë dhe hyjnë në ring së bashku. Kjo ka kuptim në botë. Unë mund ta shoh atë duke ndodhur pa marrë parasysh çfarë", ka thënë DuBoef.

### SHKURT

#### Zidane përjashton kalimin tek Unitedi: Nuk e flas rrjedhshëm anglishten

Zinedine Zidane ka dhënë një intervistë për prestigjiozën franceze "L'Equipe" në një çast delikat. Si Manchester Unitedi edhe Franca kanë vendosur në dyshim të ardhmen e trajnerëve respektivë dhe fjalët e ish-numrit dhjetë të transalpinëve i kanë hedhur edhe më shumë "benzinë zjarrit". "A do të më pëlqente të shkoja në Manchester? Kuptoj anglishten, por nuk e flas rrjedhshëm. Unë kam parë trajnerë të cilët kanë pranuar të punojnë në vende ku nuk dinë të thonë as mirëmëngjesi, por unë nuk jam ashtu, punoj ndryshe. Që të fitosh duhet të kesh disa elemente. Unë i di ato. Di se çfarë duhet për të fituar", ka thënë Zidane.

#### Odegaard pëson lëndim të rëndë dhe largohet nga fusha duke qarë

Kombëtarja e Norvegjisë e mposhti Austrinë me rezultat 2:1 në xhiron e dytë të Ligës B të Ligës së Kombeve. Norvegjezët kaluan në avantazh në minutën e nëntë me golin e Felix Myhre dhe austriakët barazuan me Marcel Sabitzer në minutën e 37. Erling Haaland i solli fitoren Norvegjisë në minutën e 80 të lojës, por lajmi kryesor është lëndimi potencialisht i rëndë i kapitenit norvegjez Martin Odegaard në minutën e 65-të të ndeshjes. Ai u largua nga loja në minutën e 67 pas një dueli me Christoph Baumgartner. Të dy po luftonin për topin dhe pas kontaktit me austriakun, Odegaard shkeli në mënyrë të sikletshme në këmbën e majtë dhe e ndrydhi kyçin e këmbës. Ai përfundoi në lëndinë me dhimbje të mëdha dhe u largua nga fusha me lot në sy. Nuk dihet ende shkalla e dëmtimit, por e sigurt është që Odegaard do t'i humbasë së paku ndeshjet ndaj Tottenhamit në fundjavë dhe Atalantas në mesjavën e ardhshme, derisa mbetet në dyshim për derbin ndaj Manchester Cityt më 22 shtator.

#### Calhanoglu: Pas 21 vitesh një lojtar turk është rikthyer sërish në garën për 'Topin e Artë'

Mesfushori i Interit dhe Turqisë, Hakan Calhanoglu, ka folur për mediet vendase pas fitores 3-1 ndaj Islandës. Mesfushori ka thënë se mund të duket i paftyrë, por pas 21 vitesh një lojtar turk është rikthyer sërish në garën për "Topin e Artë". "Kur vjen puna për mua, gjithmonë ka kritika. Po përpiqem të bëj shurdhin. Ndoshta dukem si i paftyrë, por pas 21 vitesh një lojtar turk është rikthyer sërish në garën për 'Topin e Artë'. Unë jam krenar për këtë. Në fund të fundit i shërbej vendit tim në mënyrën më të mirë të mundshme". Muajt e fundit qëndrimi i tij tek Interi ishte vënë në pikëpyetje: "Kam marrë disa oferta gjatë verës, por vendosa me zemër të qëndroja tek Interi. Edhe nëse mendoja ndryshe, Interi nuk do të më linte të shkoja askund, gjithsesi. Pra, siç thashë, nuk është diçka në fuqinë time. Do të përpiqem të luaj në nivelin më të lartë të mundshëm. Për sa i përket ekipit kombëtar, dua të jem në gjendje të luaj ndeshjen e 100 me Turqinë".

## Federata kineze përjashton përjetë 43 persona për kurdisje ndeshjesh

Federata Kineze e Futbollit ka përjashtuar përgjithmonë 43 persona, duke përfshirë 38 lojtarë dhe pesë zyrtarë të klubit, mbi akuzat për trukime ndeshjesh dhe forma të tjera korrupsioni.

Agjencia zyrtare e lajmeve kineze "Xinhua" raporton se Zhang Xiaopeng, një zyrtar i lartë i policisë, dha detaje të një "hetimi dyvjeçar që zbuloi një sërë rastesh të lojërave të fatit në internet,

kurdisje të ndeshjeve dhe korrupsionit". Sipas Xinhua, hetimi përfshinte 120 ndeshje, 128 të dyshuar dhe 41 klube. Lojtarë dhe zyrtarë të tjerë u janë dhënë pezullime të reduktuara

dhe mes tyre ka lojtarë të huaj të joshur në Kinë nga premtimi për paga të larta. Në mesin e atyre që janë ndaluar përjetë nga ky sport janë ish-lojtarët e kombëtares kineze Jin Jingdao, Guo Tianyu

dhe Gu Chao. Kina do të përballlet sot në Dalian me Arabinë Saudite në raundin e tretë të kualifikimeve aziatike për Botërorin 2026, 5 ditë pas humbjes 7-0 ndaj Japonisë.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË**  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Numër: 1393/1  
 Datë: 10.09.2024

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 Ligjit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 7/26 Mars), në bazë të Ligjit Nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së miratuar të dt. 09.09.2024 me nr. 530 nga **QeK "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë** shpall:

## Ftesë për ofertë

**Për ekskursion të maturanëve të QeK "Shtjefën Gjeçovi" - Prishtinë, në Republikën e Shqipërisë**

**Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.**

**Agjencioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:**

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfort dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi për marrëveshje me hotelin ku mendon me i derguar nxënësit ( **KDSH ka përcaktuar datat nga 30.09.2024 dhe 01, 02, 03, dhe 04.10.2024-katër netë, dhe preferon vendosjen në kompleksin Hotel Bonita - Durrës**).
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE), se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumentet kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumenteve kulturo-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (2021-2022-2023)
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskurzion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskurzion.
- Agjencioni duhet të ofrojë dëshminë me shkrim nga Hoteli se ka rezervuar vendosjen e nxënësve për datat e caktuara nga KDSH.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

### Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimit nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë,
- Pamvaresisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskurzion,
- Hoteli të posedojë sallë për ballo,
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner),
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrës, Krujë, Berat, Vlorë etj.

### Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e AAAPARr në Prishtinë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi ofertues
- Lloji i Hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Numri i nxënësve që udhëtojnë falas
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat

Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutur do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfë (në zarfën e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfën e madhe e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorëzohen në zyret e AAAPARr në Prishtinë (Rruga „Agim Ramadani” p.n. ndërtesa MASHTI II, në katin e tretë, në objektin përball Fakultetit Ekonomik dhe Juridik në Prishtinë)

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

**Afati i paraqitjes së ofertave është shtatë ditë ( ditën e fundit dokumentet pranohen deri në ora 14:00 ) nga dita e shpalljes në gazetën ditore.**



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "BDS Services Prishtina" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330315756.

- Art Doda shpall te pavlefshme dëftesën e vitit X QK "11 Marsi" Prizren

- Ernes Avdaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Mic Sokoli" Lubeqevë

- Sali Morina shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren

- Blead Maxhuni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SHMU "Ahmet Rrustemi", Bec komuna e Gjakovës, nga klasa e 6-9.

- Gerti Murtezaja nga Beci i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e SHMU "Ahmet Rrustemi", Bec komuna e Gjakovës, nga klasa e 6-9.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



## SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar/e për Analiza të Investimeve
<b>Grada e pozitës:</b>	gjashtë (6)
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	me afat të pacaktuar
<b>Departamenti:</b>	Departamenti për Menaxhimin e Mjeteve
<b>Divizioni:</b>	Divizioni i Investimeve
<b>I raporton:</b>	Udhëheqësit të Divizionit për Investime

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatitë raporte mujore, gjashtemujore dhe vjetore për Divizionin e Investimeve në pajtim me zbatimin e Politikës Investive;
- Ndihmon në përgatitjen e raporteve për Komitetin e Investimeve dhe Likuiditetit;
- Kujdeset për hulumtimet dhe operacionet ditore të investimeve të Zyrës së Pasmë në mungesë të Zyrtarit të Operacioneve Investive;
- Kryen analizat ditore të likuiditetit dhe përpunon informatat ditore të tregut dhe paraqet efektin e tyre në vendimet investive;
- Kontrollon gjendjen e llogarive tona ditore (llogaritë nostro të BQK-së) në baza ditore;
- Koordinon aktivitetin e investimeve me Zyrën së Pasmë dhe Auditimin e Brendshëm lidhur me të gjitha transkacionet e procesuara në i-flex;
- Mban kontakt me zyrtarët e llogarive dhe dilerëve të bankave me të cilat bashkëpunon BQK;
- Grumbullon, monitoron dhe analizon të gjitha informatat relevante në lidhje me tregjet financiare botërore në baza ditore nga Bloombergu;
- Njofton klientët e BQK-së për ndryshimin e normës referuese;
- Hulumton dhe përcjell gjendjen e bankave me të cilat bashkëpunon BQK;
- Hulumton bankat potenciale për mundësitë e reja të investimeve;
- Kryen analiza rreth gjendjes së tregut financiar dhe jep sugjerime të bazuara në këto analiza;
- Përgatitë raporte mbi tregjet financiare dhe ngjarjet ekonomike;
- Informon në baza ditore lidhur për lëvizjen e EONIA-s dhe Euribor-it dhe mundësinë e ndryshimit të normës së instrumentit depozitar (deposit facility rate);
- Kryen përgatitjen e raporteve (ad hoc raporteve) lidhur me Rangimin Kreditor dhe të tjera punë të Zyrës Frontale;
- Detyrat tjera të cilat caktohen kohë pas kohe nga Mbikëqyrësi.

### Dituritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në Fakultetin Ekonomik, Banka dhe Financa apo Administrim Biznesi;
- Përvoja në sistemin financiar, banka komerciale apo në ndonjë institucion tjetër financiar;
- Të jetë i/e rrjedhshëm në gjuhë shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

### Përvoja e kërkuar:

- Minimum dy (2) vite përvojë pune profesionale në sistemin financiar, preferohet përvoja në tregun e letrave me vlerë.

### Kërkesat e posaçme:

- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioritetëve;
- Aftësi të shkëlqyera kuantitative dhe analitike;
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office të ngjashme;
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Vetëiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;
- Ruajtja e fshehtësisë afariste.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **25 shtator 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

<b>Naziv radnog mesta:</b>	Službenik/ca za analizu ulaganja
<b>Nivo stepena:</b>	Šest (6)
<b>Trajanje radnog odnosa:</b>	Na neodređeno vreme
<b>Odeljenje:</b>	Odeljenje za upravljanje imovinom
<b>Odsek:</b>	Odsek za ulaganja
<b>Izveštava:</b>	Rukovodioc sektora za ulaganja

### Dužnosti i odgovornosti:

- Priprema mesečne, šestomesečne i godišnje izveštaje za Sektor za ulaganja u skladu sa sprovođenjem politike ulaganja;
- Pomaže u pripremi izveštaja za Komitet za ulaganja i likvidnost;
- Vodi računa o istraživanju i svakodnevnim operacijama ulaganja Back Office-a u odsustvu službenika za operacije ulaganja;
- Vrši dnevnu analizu likvidnosti i obrađuje dnevne tržišne informacije i predstavlja njihov uticaj na odluke o ulaganju;
- Proverava stanje na našim dnevnim računima (nostro računi CBK-a) na dnevnoj bazi;
- Koordinira aktivnost ulaganja sa Back Office-om i Internom revizijom u vezi sa svim transakcijama obrađenim u i-flex-u;
- Održava kontakt sa službenicima računa i dilerima banaka sa kojima sarađuje CBK;
- Svakodnevno prikuplja, prati i analizira sve relevantne informacije o svetskim finansijskim tržištima od Bloomberg-a;
- Obaveštava klijente CBK-a o promeni referentne stope;
- Istražuje i prati situaciju banaka sa kojima CBK sarađuje;
- Istražuje potencijalne banke za nove mogućnosti ulaganja;
- Vrši analize stanja na finansijskom tržištu i na osnovu tih analiza daje predloge;
- Priprema izveštaje o finansijskim tržištima i ekonomskim događajima;
- Svakodnevno informiše o kretanju EONIA i Euribor-a i mogućnosti promene stope instrumenta depozita (deposit facility rate);
- Priprema izveštaje (ad hoc izveštaje) u vezi sa kreditnim rejtingom i drugim poslovima Front Office-a;
- Drugi zadaci koje s vremena na vreme dodeljuje supervizor;

### Potrebna znanja:

- Da je diplomirao na Ekonomskom fakultetu, Banke i Finansijske ili poslovne administracije
- Iskustvo u finansijskom sistemu, komercijalnim bankama ili bilo kojoj drugoj finansijskoj instituciji;
- Da tečno govori albanski i/ili srpski jezik;
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

### Potrebno iskustvo:

- Najmanje dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva u finansijskom sistemu, poželjno je iskustvo na tržištu hartija od vrednosti.

### Posebni zahtevi:

- Veštine pismene komunikacije kao i sposobnost rešavanja problema prema prioritetima;
- Odlučne kvantitativne i analitičke sposobnosti;
- Odlučno poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office slično;
- Pažnja na detalje, jasne formulacije i tačnost;
- Samoinicijativnost i spremnost za timski rad;
- Održavanje poslovne poverljivosti.

### Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili uverenja poslodavca ili drugi relevantni dokumenti kojima se dokazuje radno mesto i radno iskustvo, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka)
- Izveštaj Kosovskog penzijskog štednog fonda (TRUST-a)** za odgovarajući period ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje radnog iskustva ili poresko uverenje Poreske administracije (PAK) kada se izveštaj Trusta zakonski ne primenjuje;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju da budu zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

### Postupak podnošenja aplikacije:

- Zadnji rok za podnošenje aplikacija je **25 septembar 2024. godine**.
- Aplikacija se može podneti online (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali oblici prijavlivanja neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti sa zvanične stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





# TRADITË QË NGA 1992

